

**Kreditimi Rural i Kosovës SH.P.K.**, është Institucion Mikrofinanciar i regjistruar në BQK, me mision të ofroj shërbime financiare për klientët me të ardhura të ulëta, me fokus të veçantë për bizneset mikro, të vogla, bujqësore dhe aktivitetet tjera në zonat rurale dhe urbane, me fokus prioriteti në bujqësi dhe një vëmendje të veçantë për qëndrueshmërinë financiare, sociale dhe mjedisore.

Kreditimi Rural i Kosovës Sh.p.k shpall:

## **K O N K U R S**

Për rekrutim të pozitave si në vijim:

- 1) Një (1) **Analist-e Kreditor-e** për degën në **Pejë**
- 2) Një (1) **Analist-e Kreditor-e** për degën në **Shtime**
- 3) Një (1) **Analist-e Kreditor-e** për degën në **Gjilan**

### **Përgjegjësitë:**

- Promovimi i ofertës kreditore përmes kontaktit me klient,
- Analiza e kërkesave kreditore, prezantimi i tyre në komitetin kreditor dhe vlerësimi i kolateralit,
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e kredive, mbikëqyrja e kthimit të kredive dhe regjistrimi i tyre në programin adekuat,
- Raportim në zyrën qendrore për aktivitetin kreditor,
- Punë të tjera administrative të ndërlidhura me kredi-dhënien.

### **Kushtet e kërkuara:**

- Diplomë universitare në ekonomi apo bujqësi, etj.(e preferueshme),
- Përvojë pune në sektorin mikro-financiar apo bankarë (e preferueshme por nuk është kusht),
- Njohuri për kredi-dhënie dhe të jetë i/e motivuar të punoj në zona rurale dhe urbane,
- Njohuri të punës me kompjuter, të njoh Microsoft Office,
- Shkathësi të mira të komunikimit dhe negocimit,
- Të jete dinamik, fleksibil, kreativ dhe i gatshëm për punë në ekip,
- Banor i komunës për të cilën konkurren (e preferueshme),
- Të posedoj patentë shofer për kategorinë B.

Konkursi mbetet i hapur nga dt. **11.08.2022** deri me dt. **17.08.2022**. Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë vetëm duke plotësuar aplikacionin për pozitën përkatëse në linkun: <http://krk-ks.com/vendepune>

**Vetëm një numër i përzgjedhur i kandidatëve do të ftohet në intervistë.**

*KRK ofron zhvillim profesional dhe pako konkurruese të kompensimit në përputhje me përgjegjësitë dhe përvojën.*

Kreditimi Rural i Kosovës është i përkushtuar të ofroj mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës.